



KUVENDI

Tiranë, më ____ / ____ 2019

Lënda: Amendament për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar””.

Drejtuar: Z.Gramoz RUÇI

KRYETAR I KUVENDIT TË SHQIPËRISË

Tiranë

I nderuar Z. Kryetar,

Mbështetur në nenin 75 pika 4 të Rregullores së Kuvendit, paraqes për shqyrtim dhe miratim në Kuvend amendamentin mbi projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar””.

Bashkëlidhur gjeni tekstin e amendamentit dhe relacionin shoqërues.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

Deputeti propozues

Deputeti propozues

1/ko Bepaj

Bepaj

AMENDAMENT

“Neni 3 i projektligjit të ndryshohet si më poshtë:

“Neni 3
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi në datën 1 janar 2020.””

RELACION

Parimisht shprehem dakord për nismën e Këshillit të Ministrave për vendosjen e detyrimit që tatimpaguesit të regjistruar për tatimin mbi vlerën e shtuar, si dhe organizatat jofitimprurëse të regjistruara në organin tatimor, të kenë llogari bankare biznesi/organizate të regjistruar dhe ta deklarojnë atë në administratën tatimore.

Duke qënë se parashikueshmëria është nja nga parimet e rëndësishme të administrimit fiskal, jam i mendimit se subjekteve që do jenë objekt i këtij detyrimi të ri është e nevojshme t’u lihet kohë e mjaftueshme për t’u njohur dhe marrë masat për ta zbatuar. Për më tepër që hyrja në fuqi e kësaj dispozite pritet të ndodhë gjatë muajit korrik që përkon edhe me periudhë pushimesh.

Për këtë arsye propozoj që hyrja në fuqi e këtij ligji të jetë në datën 1 janar 2020.

